7

**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

Datë 10.06.2025

## RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË SHPËRNDARJES SË SUBVENCIONIMIT PËR OPERATORËT E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK QYTETAS NË BASHKINË DURRËS**

**Baza ligjore:**

Neni 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 23, pika 6, nenit 54, shkronja k, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 3743, datë 10.7.2017, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë "Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve, të ndryshuar, VKB-së nr. 590, datë 11.03.2019, "Për miratimin e ndryshimit të VKB- nr.233, datë 16.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus", Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027.

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë të konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e procedurës së shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në Bashkinë Durrës.
2. Miratimin e kompensimit nga ana e Bashkisë Durrës të vlerës 10 lekë nga vlera totale e çmimit të biletës 40 lekë.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Efektet financiare të këtij kompensimi do të përballohen nga buxheti i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027.

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Shërbimeve.

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorët Bashkisë Durrës dhe Njësive Administrative.

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*JO.*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mblodhë më datë 10.06.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 7 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Nuk ka pyetje.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- ___________________________________

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Kryetar | Marsida Feshti |
| 2 | Zv/Kryetar | Sami Osmani |
| 3 | Sekretar | Joniada Musaraj |
| 4 | Anëtar | Dorian Isaj |
| 5 | Anëtar | Elisabeta Mataj |
| 6 | Anëtar | Flutura Kasa |
| 7 | Anëtar | Edlira Shemsi |
| 8 | Anëtar | Kontjana Kuçi |
| 9 | Anëtar | Erald Dalipi |

Pjesëmarrës nga Bashkia
Almida Roshi